

1 E enjte, 9 tetor 2023

2 [Paraqitja e parë e Sabit Januzit]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Sabit Januzi hyn në sallën e
5 gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 15.15

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirë se erdhët
8 të gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

9 Përpara se të fillojmë, sikurse e kam theksuar në
10 vendimin për Caktimin e Datës së kësaj Paraqitje të Parë, do
11 të bëhen disa fotografi, por më kanë thënë se doni të keni të
12 njëjtën fotografi pa fotografi prej së afërmi të klientit
13 tuaj. A është kjo e saktë?

14 Z. GILLIS: [Përkthim] Po

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë do t'i kërkoj
16 fotografes që të bëjë të njëjtat fotografi sikurse në seancën
17 paraprake për një minutë e gjysëm, pa bërë fotografi prej afër
18 të të akuzuarit.

19 Faleminderit, zonja fotografe.

20 Tani znj. Sekretare, ju lutem, të paraqisni lëndën.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,,
22 është lënda KSC-BC-2023-10, Prokurori i Specializuar kundër
23 Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

25 Sekretare.

1 Përpara se t'ju kërkoj të pranishmëve në sallë që të
2 prezantohen, dua që t'u kujtoj të gjithëve edhe një herë
3 rregullat të cilave duhet t'u përmbaheni gjatë të gjithë kohës
4 në mënyrë që seanca të ecë në mënyrë të papenguar.

5 Ju lutem, ndizni mikrofonin përpara se të flisni dhe
6 fikenit atë kur të përfundoni së foluri. Flisni ngadalë dhe
7 qartë meqë kemi përkthim në shqip dhe në serbisht. Prisni pesë
8 sekonda përpara se të më përgjigjeni mua, apo një pale ose
9 pjesëmarrësi, në mënyrë që përkthyesit të mund të përfundojë
10 përkthimin.

11 Ajo që thuhet në këtë seancë do të transkribohet në kohë
12 reale dhe do të pasqyrohet në një transkript i cili do t'ju
13 vihet në dispozicion palëve dhe publikut pas kësaj seance.

14 Gjithashtu, dua t'i rikujtoj palëve se disa informacione
15 në këto çështje janë objekt i masave mbrojtëse dhe urdhrave
16 për konfidencialitet. Informacioni konfidencial nuk nxirret në
17 seancë të hapur në qoftë se një palë apo pjesëmarrës do të
18 kalojnë në seancë private për t'ju referuar një informacioni
19 konfidencial, atëherë duhet t'i paraqesë arsyet për këtë.

20 Tani do t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrëseve të
21 prezantohen.

22 Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

23 Z. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

24 Unë jam Taz Shahabudin. Afër meje është Joshua Hafetz, kam
25 gjithashtu përfaqësuesin e Prokurorisë John Devaney dhe Fabian

1 Unser-Nad.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Tani fjalën ja jap Mbrojtësit.

4 Z. GILLIS: [Përkthim] Unë jam Thomas Gillis, jam anëtar i
5 Shoqatës së Avokatëve të Belgjikës dhe jam Mbrojtësi kujdestar
6 i z. Sabit Januzi.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

8 Për hir të transkriptit rikujtoj që në sallë është i
9 pranishëm edhe z. Januzi.

10 Fjalën tani ia jap Zyrës Administrative.

11 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, unë jam Jonas Nilsson,
12 jam zëvendës Administrator dhe përfaqësoj Zyrën Administrative
13 së bashku me Njësinë për Administrimin e Punëve të Gjykatës

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake
16 në këtë çështje.

17 I akuzuari paraqitet për herë të parë sot, pas
18 konfirmimit të aktakuzës kundër tij.

19 Z. Januzi, ju lutem, ngrihuni në këmbë.

20 A mund të na thoni emrin dhe mbiemrin?

21 I AKUZUARI JANUZI: Po. Unë jam Sabit Januzi

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Data e lindjes dhe vendi i
23 lindjes.

24 I AKUZUARI JANUZI: Jam i lidhur më 29.04.1966 në vendin e
25 quajtur Fushticë e Epërme

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Çfarë nënshtetësie ose
2 nënshtetësi keni? Në qoftë se janë më shumë?

3 I AKUZUARI JANUZI: Nënshtetësi kosovare

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe cili është profesioni
5 juaj aktual?

6 I AKUZUARI JANUZI: Aktualisht jam vetëm pensioner,
7 veteran. Në të kalumen kam qenë murator

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi,
9 mund të uleni.

10 Tani do të kaloj tek historiku procedural i kësaj
11 çështje.

12 Me 2 tetor 2023 si Gjykatësi i Procedurës Paraprake
13 konfirmova aktakuzën që parashtroi ZPS-ja kundër z. Januzi në
14 të cilën ai akuzohet për veprat penale: Pika 1, tentim për
15 pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare
16 përmes kërcënimit të rëndë; Pika 2, tentim për pengimin e
17 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes
18 pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi; dhe Pika
19 3, frikësim gjatë procedurës penale.

20 Me 5 tetor 2230 ZPS-ja arrestoi z. Januzi në Kosovë, kur
21 atij edhe iu dorëzua aktakuza e konfirmuar. Z. Januzi u
22 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
23 Specializuara të Kosovës në Hagë me 6 tetor 2023.

24 Z. Januzi, përpara se të vazhdojmë, dua të sigurohem se
25 mund t'i ndiqni procedurat në një gjuhë që e kuptoni dhe e

1 flisni. A mund të konfirmoni që e kuptoni dhe e flisni gjuhën
2 shqipe?

3 I AKUZUARI JANUZI: Po.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.
5 Rrjedhimisht jam bindur që mund t'i ndiqni procedurat në
6 shqip, një gjë që e flisni dhe e kuptoni në përputhje me
7 rregullën 92 të Rregullores së Procedurave dhe të Provave. Dhe
8 z. Januzi në qoftë se në ndonjë moment gjatë kësaj seance nuk
9 e dëgjoni apo merrni përkthimin, ju lutem, të ma bëni me dije
10 menjëherë.

11 Tani më lejoni që të shpjegoj qëllimin konkret të
12 Paraqitjes së Parë në dobi të të akuzuarit dhe atyre që na
13 ndjekin nga galeria, për publikun apo përmes internetit.

14 Seanca e sotme nuk është gjykim. Nuk do të paraqiten dhe
15 as debatohen prova. Dhe fajësia apo pafajësia e të akuzuarit
16 nuk do të diskutohet dhe as që do të merret vendim në lidhje
17 me këtë. Qëllimi i kësaj seance rregullohet me nenin 39 të
18 Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores.

19 Sipas këtyre dispozitave, si Gjykatës i Procedurës
20 Paraprake, unë siguroj që akuzat e paraqitura në Aktakuzën e
21 Konfirmuar t'i lexojnë të akuzuarit në një gjuhë që e kupton
22 dhe flet; të konfirmoj se i akuzuari e kupton Aktakuzën; të
23 bindem se të drejtat e të akuzuarit, veçanërisht e drejta e
24 tij për përfaqësim ligjor janë respektuar; të informoj të
25 akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita e sotme do të ftohet që

1 të vetë deklarohehet në lidhje me fajësinë apo pafajësinë.

2 Për secilën pikë të paraqitur në aktakuzë, në qoftë se
3 dëshiron i akuzuari, mund ta bëjë menjëherë këtë, pra të
4 vetëdeklarohehet në lidhje me fajësinë apo pafajësinë.

5 Dhe në fund do të caktoj edhe data të tjera sipas nevojës
6 në kryerjen e detyrave të mia si Gjykatës i Procedurës
7 Paraprake. Pres palët që t'u përmbahen këtyre pikave të rendit
8 të ditës të cilat do t'i trajtojmë një nga një. Dhe përsëri në
9 qoftë se ndonjëra prej palëve dëshiron të diskutojë ndonjë
10 çështje që nuk është paraparë në kuadër së seancës së
11 paraqitjes së parë, ftohen ato që këtë ta bëjnë me shkrim
12 përmes parashtrime me shkrim.

13 Së pari z. Januzi, a mund të na konfirmoni se e keni
14 marrë Aktakuzën e Konfirmuar në një gjuhë që e kuptoni dhe e
15 flisni?

16 I AKUZUARI JANUZI: Po, e kam marrë në gjuhën shqipe.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.

18 Tani do t'i kërkoj Sekretares që t'i lexojë akuzat e
19 paraqitur në Aktakuzën e Konfirmuar, sikurse parashtrohet në
20 nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në Aktakuzën e
22 Konfirmuar Prokurori i Specializuar akuzon z. Sabit Januzi
23 për:

24 Pika 1: Tentim për pengim të personave zyrtarë në
25 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë, e

1 ndëshkueshme në bazë të nenit 401(2) dhe (5) të Kodit Penal të
2 Kosovës të vitit 2019 dhe nenit 15(2) të Ligjit.

3 Pika 2: Tentim për pengim të personave zyrtarë në
4 kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimet
5 e përbashkëta të një grupi, e ndëshkueshme sipas nenit 401(1)
6 dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit
7 15(2) të Ligjit; dhe

8 Pika 2: Frikësimin gjatë procedurës penale, e
9 ndëshkueshme në bazë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës të
10 vitit 2019 dhe nenit 15(2) të Ligjit.

11 Këto vepra penale u kryen, midis më së paku, 5 dhe 12
12 prillit 2023.

13 Në lidhje me këto vepra penale ekziston dyshimi i bazuar
14 mirë se z. Sabit Januzi mban përgjegjësi penale sipas nenit
15 16(3) të Ligjit për:

- 16 (a) Kryerja të veprave penale në pikën 3, në bazë të
17 nenit 17 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019;
- 18 (b) Bashkëkryerje me z. Ismet Bahtjari të veprave penale
19 në pikat 1 deri në 3 në bazë të nenit 31 të Kodi
20 Penal të Kosovës të vitit 2019;
- 21 (c) Ndhimë në kryerjen e veprave penale në pikat 1, 2
22 dhe 3 në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës
23 të vitit 2019;
- 24 (d) Marrëveshje për të kryer me z. Ismet Bahtjari vepra
25 penale në pikat 1 deri në 3 në bazë të nenit të

1 Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019; dhe/ose
2 (e) Tentim për të kryer vepra penale në pikat 1 deri 2
3 në bazë të nenit 28 të Kodit Penal të Kosovës të
4 vitit 2019.

5 Faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

7 Sekretare.

8 Z. Januzi dua t'ju kujtoj se nuk është momenti për t'i
9 kundërshtuar akuzuat, por thjesht se i kuptoni ato. Do të keni
10 mundësi të bollshme që t'i kundërshtoi akuzat nëpërmjet
11 Mbrojtësit tuaj.

12 Z. Januzi, a i kuptuat akuzuar e paraqitura në Aktakuzën
13 e Konfirmuar ashtu sikurse i lexoi Sekretarja?

14 I AKUZUARI JANUZI: Besoj se po.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi,
16 mund të uleni.

17 Tani më lejoni t'u informoj për të drejtat që keni para
18 kësaj Gjykate. Ligji për Dhomat e Specializuar dhe Rregullorja
19 e Procedurës dhe Provave ju garantojnë një numër të drejtash
20 dhe unë do t'ua lexoj ato që janë më të rëndësishme.

21 Së pari, prezumoheni i pafajshëm derisa të vërtetohet
22 fajësia juaj përtej dyshimit të arsyeshëm në shqyrtimin e
23 akuzave kundër jush. Keni të drejtën për gjykim të drejtë dhe
24 publik, në vartësi të masave të urdhëruara për mbrojtjen e
25 viktimave dhe dëshmitarëve.

1 Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe me hollësi në
2 një gjuhë që ju e kuptoni për natyrën dhe arsyet e akuzave
3 kundër jush.

4 Keni të drejtën të keni kohën dhe mjetet e mjaftueshme
5 për përgatitjen e Mbrojtjes dhe të komunikoni Mbrojtësin që
6 zgjidhni vetë.

7 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të
8 arsyeshme.

9 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
10 mbroheni përmes Mbrojtësit.

11 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat Mbrojtës pa
12 pagesë, në qoftë se nuk keni mjete për ta paguar atë.

13 Keni të drejtën që të merrni në pyetje apo dikush tjetër
14 të marrë në emër tuaj në pyetje dëshmitarët dhe të kërkoni
15 paraqitjen e tyre për të marrë në pyetje në emër tij.

16 Keni të drejtën të ndihmës falas të një përkthyesi në
17 qoftë se nuk e kuptoni apo flisni gjuhën që e përdorin në
18 Gjykatë.

19 Keni të drejtën që të mos detyroheni që të dëshmoni
20 kundër vetes apo të pranoni fajësinë.

21 Keni të drejtën të mbeteni në heshtje dhe prej kësaj nuk
22 nxirret kurrfarë konstatimi negativ kundër jush.

23 Keni të drejtën për të bërë deklaratë pa betim në lidhje
24 me çështje, dhe mund të paraqiteni si dëshmitar nën betim.

25 Keni të drejtën të paraqisni mocione paraprake për të

1 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara për të
2 pretenduar mangësi në formën e aktakuzës dhe për të kërkuar
3 ndarjen e akuzave.

4 Keni të drejtën të merrni brenda 30 ditësh prej datës së
5 sotme material mbështetës të Aktakuzës që është dorëzuar për
6 konfirmim.

7 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e
8 dëshmitarëve që zyra e Prokurorit synon t'i thërrasë për të
9 dëshmuar në Gjykatë, në një gjuhë që e kuptoni dhe flisni,
10 përkatësisht në shqip.

11 Keni të drejtën që të merrni menjëherë çfarëdo
12 informacioni që mund, në mënyrë të arsyeshme, të sugjerojë
13 pafajësinë tuaj apo të zbusë fajësinë tuaj apo të ndikojë në
14 besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e provave të Zyrës së
15 Prokurorit në momentin që ky informacion është në kontrollin
16 dhe njohurinë e Prokurorit.

17 Keni të drejtën të gjitha materialet dhe provat në lidhje
18 me faktet që i ka Prokurori t'ju jepen përpara fillimit të
19 procedurave apo gjatë atyre. Dhe kjo e drejtë ka kufizimet e
20 veta dhe atëherë kur janë një fuqi garanci mbrojtëse
21 balancuese.

22 Keni të drejtën që të mos mbaheni për një periudhë të
23 paarsyeshme para fillimit të çështje në paraburgim.

24 Keni të drejtën që ta apeloni, drejtpërdrejtë tek Dhoma e
25 Apelit, vendimin mbi mocionet paraprake për kundërshtimin e

1 juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

2 Keni të drejtën të kërkonit leje për ta apeluar të gjitha
3 vendimet.

4 Z. Januzi, i dëgjuat të gjitha të drejtat më të
5 rëndësishme që keni në përputhje me kornizën ligjore në fuqi
6 në Dhomat e Specializuara.

7 A i kuptoni këto të drejtat, z. Januzi? A i keni të
8 qarta?

9 I AKUZUARI JANUZI: Po.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.
11 Mund të uleni.

12 Dua t'ju informoj se sipas nenit 21(5) të Ligjit, nuk
13 mund të vetëpërfaqësoheni sepse aktualisht jeni në paraburgim
14 prandaj përfaqësimi përmes një Mbrojtësi të Specializuar është
15 i detyruar.

16 E kam për detyrë, si Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të
17 siguroj që e drejta për avokat është respektuar. Zyra
18 Administrative më ka informuar se është caktuar një Mbrojtës
19 kujdestar, gjithashtu e kam të qartë se deri në caktimin e një
20 avokati, ju është caktuar z. Thomas Gillis si Mbrojtës
21 kujdestar, në përputhje me pjesën 17(2) të Direktivës për
22 Mbrojtësit dhe rregullën 21 të Rregullores për Ndihmën
23 Juridike.

24 Z. Januzi a mund të konfirmoni që z. Thomas Gillis u
25 është caktuar si Mbrojtës kujdestar sot?

1 I AKUZUARI JANUZI: Po, e konfirmoj se po.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.

3 Mund të uleni.

4 Dhe nga kjo del se i akuzuari është aktualisht i
5 përfaqësuar nga një Mbrojtës i Specializuar.

6 Tani do të kaloj te mundësia e të akuzuarit që të
7 vetëdeklarohet në qoftë se don, në përputhje me nenin 92.

8 Z. Januzi brenda 30 ditësh nga dita a sotme do të ftoheni
9 që të pranoni fajësinë ose të vetëdeklaroheni i pafajshëm në
10 lidhje me secilën akuzë në aktakuzën e konfirmuar. Në qoftë se
11 dëshironi mund të zgjidni që tani menjëherë të deklaroheni në
12 lidhje me fajësinë apo pafajësinë.

13 Prandaj dua t'ju pyes z. Januzi, në qoftë se keni pasur
14 mundësinë që t'i diskutoni akuzat në aktakuzën e konfirmuar me
15 avokatin tuaj dhe në qoftë se jeni i gatshëm të
16 vetëdeklaroheni në këtë moment. Në qoftë se po, atëherë ju
17 ftoj që të çoheni në këmbë dhe të bëni vetëdeklarimin.

18 I AKUZUARI JANUZI: Po, jam i gatshëm dhe deklarohe
19 plotësisht i pafajshëm në çdo lloj aktakuze që është ngritur
20 kundër meje dhe që është lexuar deri më tani.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.

22 Mund të uleni.

23 Tani, do të kaloj tek gjuhët e punës për këtë procedurë
24 në vendimin për caktimin e datës kërkova palëve që të bëjnë
25 parashtrime në lidhje me gjuhën e punës që do të përdoret në

1 këtë proces në bazë të rregullës 8. Tani do t'i pyes palët që
2 t'i bëjnë të ditura preferencat e tyre për hir të
3 procesverbalit.

4 Z. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit, ne preferojmë që
5 procedura të zhvillohet në anglisht.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Gillis.

8 Z. GILLIS: [Përkthim] Po, në anglisht, ju lutem

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të nxjerr një vendim në
10 lidhje me këtë më vonë, mirëpo do të mbaj parasysh
11 parashtrimet e tyre.

12 Në vendimin për caktimin e datës së kësaj seance të
13 paraqitjes së parë bëra të ditur që kam ndërmend që të caktoj
14 edhe mbajtjen e një Konferencë për Ecurinë e Çështjes, të
15 enjten me 12 tetor në orën 2. Qëllimi i kësaj seancë është që
16 të sigurojmë që të ketë shkëmbime midis palëve në mënyrë që të
17 përgatitet sa më shpejt gjykimi.

18 Z. Januzi, unë ju rikujtoj që keni të drejtë të merrni
19 pjesë në Konferencën për Ecurinë e Çështjes së bashku me
20 Avokatin tuaj. Megjithatë, me pëlqimin me shkrim dhe pasi të
21 konsultoheni me Mbrojtësin tuaj, në bazë të rregullës 96(2)
22 konferenca -- në konferencë mund të merrni pjesë si vijon: me
23 praninë tuaj me pjesëmarrjen e Avokatit përmes
24 videokonferencës, me mungesën tuaj me praninë e Mbrojtësit
25 tuaj përmes pranisë fizike, ose videolidhjes.

1 Në qoftë se Avokati do të marrë pjesë nëpërmjet
2 vidoekonferencës, duhet të bëjë një njoftim me shkrim brenda
3 24 orësh përpara seancës së tillë në mënyrë që Zyra
4 Administrative t'i bëjë përgatitjet e tyre. Dhe njoftimi i
5 tillë duhet t'i dërgohet me email Zyrës Administrative dhe
6 duhet të përfshijë edhe pëlqimin me shkrim të të akuzuarit.

7 Tani do t'i drejtohem Mbrojtjes me pyetje në qoftë se ka
8 ndërmend të marrë pjesë në Konferencën e Parë për Ecurinë e
9 Çështjes me prani fizike ose përmes videolidhje.

10 Z. Gillis.

11 Z. GILLIS: [Përkthim] Unë do të jem i pranishëm
12 fizikisht, po kështu do të jetë i pranishëm edhe klienti im.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

14 Z. Prokurore, ju a keni diçka për të shtuar në lidhje me
15 Konferencë për Ecurinë e Çështjes.

16 Z. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Do të merrni agjendën, rendin e ditës, sigurisht sonte
19 apo nesër në mëngjes. Do t'ju kërkoj palëve që të bëjnë
20 parashtrime në lidhje me temat e paraqitura për Konferencën e
21 Ecurisë së Çështjes. Dhe i njoftoj palët që caktoj të
22 mërkurën, 11 tetor deri në drekë si afat për paraqitjen e
23 këtyre parashtrimeve. Do të nxjerr edhe një vendim për
24 detyrimin e nxjerrjen e materialeve të Prokurorisë në
25 përputhje me rregullën 102 dhe në lidhje me sistemin e

1 redaktimeve për këtë proces. Përpara se ta bëj këtë, do të
2 kërkoj parashtrime prej palëve, dhe në këtë drejtim i
3 këshilloj palët që t'i shikojnë edhe një herë të gjitha
4 vendimet kornizë që kam nxjerrë lidhur me nxjerrjen e
5 materialeve në çështje të tjera.

6 Tani do t'i pyes palës në qoftë se kanë ndonjë çështje
7 tjetër për të ndritur në seancën e sote. Do të filloj me
8 Prokuroren.

9 Z. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të ngritur
10 në këtë moment.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.
12 Avokat.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të
14 ngritur në këtë moment.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Januzi, dua t'ju pyes në qoftë se keni për të ngritur
17 ndonjë çështje në lidhje me arrestimin tuaj, transferimin apo
18 paraburgimin.

19 I AKUZUARI JANUZI: Po, jam arrestuar me datën 5 tetor në
20 mëngjes, në orën 6.35 ose 40 minuta. Por me datën 4 tetor kam
21 qenë thirrur të shkoj në zyrat e EULEX-it, të paraqitem para
22 Prokurorit për një deklaram.

23 Dhe kam shkuar vetë pa prezencën e policisë, me autobus.
24 Aty më është bashkëngjitur edhe një avokat që kam kërkuar të
25 vijë dhe kemi shkuar bashkë me avokatin.

1 Ditën e nesërme, me 5 tetor, për çudi, nuk jam ftuar të
2 shkoj, por është dërguar polica e EULEX-it dhe jam arrestuar
3 para portës së shtëpisë time ashtu siç kam qenë. Më ka ftuar
4 hetuesi në telefon se a mund të dal jashtë. Kam qenë fjetë,
5 normal, po e kam dëgjuar telefonin, kam dalë dhe aty për aty
6 jam arrestuar, gjë që për mua ka qenë shumë e panevojshme
7 sepse si në datën 4 që kam shku vetë pa më arrestuar, do të
8 kisha shkuar edhe me datën 5, nëse do të ishte nevoja të
9 paraqitem pikërisht me datën 5.

10 Por, mundësia tjetër sikur të ma konfirmonin se unë kam
11 me patjetër të udhëtoj për në Tribunalin e Hagës prapë se
12 prapë do të ishte e panevojshme të arrestohem, se unë ftesës
13 së drejtësisë i përgjigjem gjithnjë.

14 Kaq kisha për t'ju thënë, z. Gjykatës

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.

16 Kjo është shënuar në procesverbal dhe e mbaj shënim.

17 Nuk e di në qoftë se kanë palët diçka për të shtuar në
18 lidhje me këtë ose me ndonjë temë tjetër?

19 Prokurore.

20 Z. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Në këtë moment nuk kemi asgjë
21 për të shtuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Gillis.

24 Z. GILLIS: [Përkthim] Në këtë moment s'kemi asgjë për të
25 ngritur.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillis.

2 Në fund, z. Januzi, me që do të mbaheni në paraburgim,
3 dua t'ju informoj se mund ta kundërshtoni mbajtjen në
4 paraburgim në bazë të rregullës 57 dhe kjo bëhet përmes
5 parashtrimeve me shkrim.

6 Me kaq përfundon seanca e sonte. Falënderoj palët, Zyrën
7 Administrative për praninë e tyre. Falënderoj personelin e
8 sigurisë, stenografin dhe përkthyesin.

9 Seanca mbyllet.

10 --- Seanca e paraqitjes së parë mbyllet në orën

11 15.44

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25